



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

Tiranë, më 12.07.2019

Dokument parlamentar

PROJEKTREZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E PUNËS SË DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE (DAP)
PËR GJENDJEN NË SHËRBIMIN CIVIL PËR VITIN 2018**

Kuvendi i Shqipërisë:

- Duke vlerësuar rolin e DAP-it si njësi përgjegjëse në kuptim të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në lidhje me përgatitjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave shtetërore në shërbimin civil, mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil në institucionet e administratës shtetërore;
- Duke mbështetur DAP-in për zhvillimin e mëtejshëm të një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të paanshëm, të pavarur dhe të bazuar në meritë;
- Duke konsideruar përparësinë e zhvillimit të mëtejshëm të reformës së Administratës Publike si një prioritet kyç për hapjen e negociatave të pranimit në Bashkimin Europian;

Vlerëson veprimtarinë e Departamentit të Administratës Publike për vitin 2018 në drejtim të:

- Zhvillimit të mëtejshëm të një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të paanshëm, të pavarur dhe të bazuar në meritë duke shënuar një rritje cilësore të procesit të rekrutimit nëpërmjet trefishimit të numrit total të aplikimeve për të gjitha pozicionet e shpallura, rritjes së përqindjes së kandidatëve të kualifikuar në nivelin 50.45% dhe rritjes së numrit mesatar të aplikantëve/pozicion pune në 22 aplikantë.

- Përmirësimi të kuadrit rregullator, nëpërmjet miratimit të 5 akteve nënligjore që propozojnë ndryshime të vendimeve të Këshillit të Ministrave, të cilat rregullojnë fusha si pezullimi, lirimi, rekrutimi në nivelin ekzekutiv, të ulët e të mesëm dejtues dhe vlerësimi i njohurive shtesë.
- Zgjerimit dhe diversifikimit të trajnimeve të ofruara për nëpunësit civilë për të gjitha institucionet e administratës publike në nivel qendror dhe lokal, me organizimin e 274 kurseve ku janë trajnuar 5554 nëpunës civilë, në krahasim me vitin 2017 ku janë organizuar 194 kurse për trajnimin e 4789.
- Hartimit dhe fillimit të implementimit të Programit për Administratën që Duam, i cili përfshin një numër aktiviteteve dhe masash të kombinuara me qëllim rritjen dhe forcimin e kapaciteteve të administratës publike, përmes modernizimit të saj dhe fuqizimit të institucioneve kyçe. Programi i cili parashikohet të ketë një shtrirje tre vjecare, gjatë vitit 2018 u përqëndrua në trajnimin në bashkëpunim të partnerëve ndërkombëtarë të 1260 punonjësve të zyrave Front Office si dhe 100 drejtuesve të lartë të administratës.
- Fillimit në tetor të vitit 2018, të zbatimit të “Reformës së shërbimit civil në administratën publike”, i cili financohet nga fondet IPA të BE-së dhe që synon mbështetjen jo vetëm të DAP, por edhe të ASPA-s dhe KMSHC-së në standartizimin dhe unifikimin e menaxhimit të shërbimit civil, të të gjithë niveleve.
- Përfshirjes së shoqërisë civile dhe palëve të tjera të interesuara në procesin e diskutimeve dhe miratimit të Planit të Veprimit 2018-2020 si dhe fillimit të zbatimit të rreth 87% të aktiviteteve të planit që në vitin e parë të veprimit të tij.
- Zgjidhjes së problematikave të evidentuara si pasojë e mungesës së administrimit në kohën e duhur të informacionit në lidhje me vendimet gjyqësore të marra për nëpunësit civilë, nëpërmjet ngritjes së platformës elektronike *administrata.al*, ku do të raportojnë të gjitha institucionet e administratës shtetërore.
- Shtrirjes së mëtejshme të sistemit HRMIS gjatë vitit 2018 edhe në 250 njësi të tjera duke e çuar numrin e institucioneve të administratës publike që përdorin sistemin në 800 struktura dhe ku mund të sigurohet informacion për mbi 50000 të punësuar.
- Rishikimit funksional strukturor dhe përmirësimi të cilësisë dhe standartizimit të përshkrimeve të punës së disa insitucioneve nëpërmjet miratimit të tipologjisë së institucioneve të varësisë së Kryeministrit dhe ministrive të linjës dhe miratimit të modelit të ri të organizimit të institucioneve të sistemit të shëndetësisë dhe arsimit parauniversitar

Kuvendi kërkon që Departamenti i Administratës Publike, për vitin 2019, të angazhohet në këto drejtime:

- Duhet të intensifikojë monitorimin së bashku me Komisionerin për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil dhe institucionet e tjera, për sjelljen e nëpunësve civilë gjatë fushatave zgjedhore si dhe të identifikojë dhe marrë masa për nëpunësit civil që veprojnë në kundërshtim me ligjin.
- Të kryejë një vlerësim të menjëhershëm mbi ndërhyrjet e nevojshme në kuadrin ligjor për nëpunësin civil, me qëllim zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë, duke propozuar edhe marrjen e masave ndaj personave përgjegjës.
- Duhet të zhvillojë një politikë gjithëpërfshirëse të pagave për një skemë pagash të drejtë, transparente dhe të bazuar në merita për t'u zbatuar nga të gjitha institucionet si dhe të propozojë ndryshime të kuadrit ligjor dhe nënligjor.
- Duhet të krijojë mekanizma ndërgjegjësimi/ informimi me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së kandidatëve me nivel të lartë kualifikimi në proceset e rekrutimit, duke publikuar shpalljet jo vetëm në portalin “online” të aplikimit, por të zgjerojë kanalet e informimit të publikut.
- Të fillojë menjëherë rishikimin e strukturave funksionale të institucioneve, me vëmendje të fokusuar tek njësitë e varësisë së ministrive.
- Të përmirësojë cilësinë e përshkrimeve të punës, të rishikojë metodologjinë e klasifikimit të pozicioneve të punës dhe të bëjë informatizimin i këtij procesit për Kryeministrinë dhe aparatet e ministrive të linjës.
- Duhet të harmonizojë dhe unifikojë procedurat për lëvizshmërinë në terësinë e sistemit shërbimit civil, nëpërmjet krijimit të një portali me akses nga të gjitha institucionet e administratës publike.

Kuvendi kërkon që Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, për vitin 2019, të angazhohet në këto drejtime:

- Të ndërmarrë menjëherë hapat e nevojshëm për realizimin e procesit të Vlerësimit të Nevojës për Trajnim, dhe për këtë qëllim të përcaktojë njësinë e brendshme përgjegjëse.
- Të përditësojë vazhdimisht dhe në kohë reale databazat me të dhënat e nëpunësve të trajnuar, duke hartuar dhe miratuar objektivat e kënaqësisë së klientit për kurset e trajnimit, si dhe të kryejë vlerësime periodike të cilësisë së trajnimeve të ofruara, sipas kërkesave të Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2015 – 2020.